



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së zhvilluar në datën 08.11.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 26 nëntor – 21 dhjetor 2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”. *(Komision për dhënie mendimi)*
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””. *(Komision për dhënie mendimi)*
5. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017". *(Komision për dhënie mendimi)*

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Silva Caka, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Rudina Bollano - Drejtore e Ekzaminimit DPPI në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Lindita Meneri - Përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizanjove dhe Treguesve Gjeografikë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Pëllumb Abeshi - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Kola -Drejtore e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani - Drejtore në Drejtorinë e Fondeve të BE-së në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëdita!

Fillojmë me diskutimin e çështjeve që kemi në rendin e ditës.

Më lejoni që në emër të të gjithë kolegëve të komisionit t’i uroj zotit Xhafaj mirëseardhjen në Komisionin e Ligjeve, për të vazhduar atë punë që e kemi nisur dhe do ta çojmë deri në fund bashkarisht. Nuk dua të flas për kontributin dhe vlerat e shtuara të këtij komisioni me rikthimin e kolegut dhe mikut tonë, zotit Xhafaj, sepse është në shtëpinë e vet natyrale në Komisionin e Ligjeve.

Mirë se erdhët, zoti Xhafaj!

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 08.11.2018. Jeni dakord me procesverbalin? Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 26 nëntor - 21 dhjetor 2018. Ka vërejtje apo sugjerime për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relatores është kolegja Elena Xhina.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Albana Shkurta, zëvendësministre, zonja Rudina Bollano, drejtore e ekzaminimit në DPPI dhe zonja Lindita Meneri, përgjegjëse e sektorit të markave, dizenjove dhe treguesve gjeografikë.

Zonja Shkurta, mirë se keni ardhur në komision!

Ju lutem, bëni shumë shkurt një prezantim të këtij projektligji për kolegët e mi deputetë, por edhe për opinionin publik. Më pas do t’ia kaloj fjalën relatores.

Fjala është për ju.

**Albana Shkurta** – Faleminderit!

Marrëveshja e Lisbonës është e veçantë në zbatimin e nenit 19 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale. Çdo vend anëtar i kësaj konvente mund të aderojë në

Marrëveshjen e Lisbonës dhe të bëhet pjesë e Asamblesë së Unionit të Lisbonës, që ka autoritetin për të modifikuar rregulloren.

Marrëveshja e Lisbonës parashikon mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të saj përmes një regjistrimi të vetëm në zyrën ndërkombëtare të WIPO-s në Gjenevë. Ajo u hartua në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar, që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë, siç janë “emërtimet e origjinës” në vende të tjera, përveç vendit të origjinës. Në mënyrë që të mund të kualifikohet për regjistrim në zyrën ndërkombëtare të WIPO-s, një emërtim origjine duhet të ketë siguruar mbrojtjen në vendin e origjinës.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është i vetmi institucion në Shqipëri që regjistron objektet e pronësisë industriale, ndër to edhe treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Sipas nenit 2 të marrëveshjes, “emërtim origjine” nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësia ose karakteristikat e të cilit i atribuohen ekskluzivisht ose në thelb mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorë natyrorë dhe njerëzorë. Pra, këto janë produkte që i kanë fituar karakteristikat, (fizikokimike, organoleptike, biologjike e të tjera) nga ndërthurja e faktorëve natyrorë (për shembull, tipi i tokës, gjeografia, klima, vegjetacioni e të tjera) me ato njerëzorë. Për shembull, njohuritë specifike mbi teknikat e përpunimit dhe metodat e prodhimit të produkteve në vendin e origjinës.

Të tilla produkte paraqesin rëndësi të veçantë për Shqipërinë pasi përmes regjistrimit kombëtar dhe më tej, atij ndërkombëtar, vlera e këtyre produkteve tradicionale mund të rritet dhe të ndikojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore dhe gastronomike.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lisbonës shton mundësitë për zhvillim për vende si yni pasi mbrojtja e kësaj kategorie treguesish gjeografikë mund të kontribuojë në zhvillimin lokal apo rural përmes rritjes së vlerës ekonomike të produkteve të tilla, përmes bërjes së njohur të këtyre produkteve në tregjet botërore dhe shtimit të prodhimit në rast eksporti.

Gjithashtu, marrëveshja parashikon se mbrojtja sigurohet kundër çdo falsifikimi ose imitimi apo përdorimi të padrejtë edhe nëse është përcaktuar origjina e vërtetë e produktit ose nëse emërtimi përdoret me emrin e përkthyer ose shoqërohet me emra të tillë, si lloji, tipi, prodhimi, imitimi ose të tjera të ngjashme, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e konkurrencës së pandershme.

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Marrëveshja ka 18 nene, që në mënyrë të përmbledhur përmbajnë

përkufizime, sigurimin e mbrojtjes, procedurën për mbrojtjen ndërkombëtare, detyrat e Asamblesë së Unionit, informacion për buxhetin e Unionit dhe mënyrën e ratifikimit dhe aderimit.

Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale (WIPO) në Gjenevë me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kontraktues. Kjo Zyrë përmban Regjistrin Ndërkombëtar të Emërtimeve të Origjinës dhe njofton formalisht shtetet e tjera kontraktuese për regjistrimin. Gjithashtu, Zyra i publikon ato në buletin zyrtar të sistemit të Lisbonës. Një shtet kontraktues mund të deklarojë brenda një viti nga marrja e njoftimit për regjistrim që nuk mund të sigurojë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës në territorin e tij, duke dërguar një deklaratë refuzimi bashkë me bazat përkatëse të refuzimit.

Që nga viti 2010, shtetet kontraktuese kanë mundësinë të lëshojnë një deklaratë për pranimin e mbrojtjes, duke përmirësuar kështu komunikimin në lidhje me statusin e regjistrimeve ndërkombëtare ndërmjet vendeve anëtare. Aktualisht janë 28 shtete anëtare që kanë aderuar në këtë marrëveshje. Projektligji është përgatitur nga Drejtoria Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Shkurta!

Fjalën e ka relatorja, zonja Xhina.

**Elena Xhina** - Faleminderit, zoti kryetar!

E falenderoj zëvendësministren për sqarimin dhe parashtrimin e plotë dhe të detajuar të projektligjit që ne sot kemi për shqyrtim! Mendoj se nuk ka më nevojë që të shtojmë detaje të tjera nga projektligji, përveç faktit që ky projektligj është paraqitur për shqyrtim dhe propozuar nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dobia që i sjell ky projektligj vendit tonë është se shumë produkteve të natyrës së veçantë të vendit tonë, të cilat identifikohen dhe nxiten për t'u certifikuar, do t'u rritet vlera, do të gjallërohen zonat rurale, do të ruhet biodiversiteti, trashëgimia kulturore dhe gastronomike, si dhe do të ofrohen mundësitë e njohjes në tregjet e huaja e produkteve shqiptare.

Në këto kushte, duke qenë se ky projektligj në aspektin ligjor dhe procedural është në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43\2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare” dhe në përputhje me nenin 18, pika 3 për sa i përket pranimit dhe miratimit të marrëveshjes ndërkombëtare që bëhet nga Kuvendi, u propozoj kolegëve të këtij komisioni ta miratojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zona Xhina!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Vazhdojmë me votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”.

Raporti për këtë projektligj t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Zonja Shkurta, shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision dhe ditë të mbarë!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26. 11. 2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””. (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Silva Caka, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Pëllumb Abeshi - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Kola - Drejtore e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Në shqyrtimin e këtij projektligji ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator do të jetë kolegu Bledar Çuçi.

Nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, zonja Vilma Kola, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave zoti Altin Bozo.

Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektligji, dua të them diçka. Unë e kuptoj shumë mirë që përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit mund të jenë personat kompetentë që janë marrë me marrëveshjen, për respektin tuaj që keni ardhur në komision nuk po e heq nga rendi i ditës, por do t’i përcillni ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nivelin e përfaqësimit. Nëse është i pamundur të vijë ministri, niveli i përfaqësimit politik mund të zbresë deri te zëvendësministri. Kjo është e qartë dhe dua t’ia përcillni ministrit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk besoj se të gjithë zëvendësministrat e Turizmit dhe Mjedisit kanë ikur në Kosovë. Gjithsesi, këtë duhet t’ia përcillni ministrit. Po e marr të mirëqenë këtë që tha zoti Çuçi, që ministri është në mbledhje qeverie në Kosovë.

Gjithsesi, zoti Abeshi, kush do ta bëjë një prezantim të shkurtër të këtij projektligji?

Fjala është për ju.

**Pëllumb Abeshi** – Ky projektligj synon të miratojë disa amendamente që janë bërë në Protokollin e Montrealit, ku Shqipëria është palë prej vitit ‘99.

Në fakt, ky nuk është amendimi i parë, por i pesti që i bëhet këtij protokollit. Synimi është që të rishikohen dhe të rivendoset një listë e re e substancave që shkaktojnë hollimin e shtresës së ozonit.

Fakti është që pas masave të marra deri tani nga Protokollin e Montrealit dhe në vazhdim të këtyre amendimeve që janë bërë rezultatet janë pozitive dhe ka informacione të sakta shkencore që është duke u përmirësuar shtresa e ozonit.

Në fakt, ky amendim përqendrohet te një grup substancash zonëholluese, si hidrofliuorokarbonet, që konsiderohen si substancat më të rrezikshme të hollimit të shtresës së Ozonit. Projektvendimi ka një listë me anekset se cilat janë substancat që përjashtohen nga kjo listë.



Ne nuk prekemi nga kjo iniciativë, pasi jemi vend importues, por pas ratifikimit të këtij protokollit detyra e Shqipërisë është që në bashkëpunim me doganat të marrë masa për të ndaluar hyrjet e këtyre substancave në vendin tonë. Po ashtu, ne kemi detyrimin që për substancat që janë aktualisht dhe përdoren nga pajisjet kryesisht ftohëse, frigoriferët dhe kondicionerët, të ndiqet procesi i trajtimit dhe asgjësimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore.

Projektligji është konsultuar me ministrinë e linjës, grupet e interesit dhe me doganat. Protokollin quhet i miratuar kur e kanë ratifikuar mbi 130 shtete. Akoma protokollin nuk quhet i ratifikuar, sepse nuk është plotësuar akoma ky numër, por ne kemi detyrimin tonë ligjor që ta ratifikojmë në raport me përgjegjësitë që kemi si vend.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Abeshi!

Zoti Çuçi e ka fjalën.

**Bledar Çuçi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thanë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Protokollin e Montrealit është një nga marrëveshjet më të rëndësishme. Konsiderohet si një nga sukseset më të mëdha të diplomacisë ndërkombëtare jo vetëm në fushën e mjedisit, pasi janë 197 vende anëtare të Protokollit të Montrealit, por sot silltet për t'u ratifikuar amendimi i radhës që, siç e tha përfaqësuesi i ministrisë, ka të bëjë me substancat HFC.

Për informacion për kolegët e tjerë, sukcesi i marrëveshjes është jo vetëm te numri i lartë dhe ndjeshmëria që ka pasur në botë, por edhe te rezultatet që po jep. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, jo vetëm objektivi është në rrugë të mbarë sipas të gjitha parashikimeve të bëra nga specialistët e fushës, por pritet që vrina e ozonit në Antarktidë të zhduket deri në vitin 2050. Pra, është një rezultat mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e globit.

Gjithashtu, kanë filluar të rikuperohen shtresat e holluara të ozonit dhe të eliminohet prodhimi e konsumi i substancave ozonholluese, që sikundër e thatë edhe ju, detyrimi ynë është të vendosim barrierë në lidhje me importimin e gjithë këtyre lëndëve.

Sigurisht, kjo marrëveshje është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, kështu që i ftoj kolegët që ta miratojmë edhe këtë amendim të Protokollit të Montrealit.

Ndërkohë, kam vetëm një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë. Për masën e parë, për vendosjen e barrierës, sigurisht që është Drejtoria e Doganave ajo që ka përgjegjësinë të mos lejojë futjen e substancave që nga momenti i ratifikimit, që nga momenti kur lind detyrimi i shtetit tonë, që të plotësohet me legjislacion vendor. Po për pjesën e dytë, të cilën ju e përmendët, që ka të bëjë me asgjësimin e atyre aparaturave që prodhohen apo që kërkojnë

substancia që përmbajnë HFC, a ka një plan masash nga qeveria shqiptare, në lidhje me mënyrën se si do të arrihet kjo gjë? Deri kur parashikohet që këto të hiqen nga qarkullimi në territorin e Shqipërisë?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

Zoti Abeshi, një përgjigje në lidhje me pyetjet e relatorit.

**Pëllumb Abeshi** – Po. Njëkohësisht, në raport e në bashkëpunim edhe me Protokollin e Montrealit, ministria ka një program, që asiston qeverinë shqiptare dhe Ministrinë e Mjedisit, program i cili monitoron gjithë procesin e zbatimit të detyrimeve të këtij protokollit. Një nga detyrimet e këtij protokollit është thjeshtë që thjeshtë të ndjekë në nivel kombëtar ecurinë e trajtimit të lëndëve ozonholluese, që dalin gjatë procesit të ndryshimit, riciklimit ose të heqjes së pajisjeve. Mbi bazën e këtij programi janë bërë trajnimet e pikave të servisit, janë licencuar subjekte të cilët trajtojnë dhe asgjësojnë këto mbetje që përmbajnë substanca ozonholluese, por njëkohësisht edhe një sistem monitorimi e raportimi, mbi bazën e këtij procesi. Mbahet edhe një regjistër, ku shënohet se si është duke ecur procesi. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe i monitorueshëm.

Natyrisht, në zbatim edhe të këtij amendimi, Protokollin e Montrealit do të miratojë fonde shtesë për vendet tonë, sidomos për vendet në zhvillim, të cilat kanë nevojë për të përmbushur këtë detyrim, që ju sapo e theksuat, pra për të monitoruar, raportuar, ndjekur dhe asgjësuar lëndët ozonholluese, të cilat nuk janë më pjesë e listës së lejuar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Bushka ka një pyetje.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, kryetar!

Duke u nisur nga rëndësia që ka miratimi i këtij amendimi të Marrëveshjes së Montrealit në Shqipëri, por edhe nga rezultatet e ka sjellë, sikundër e shpjeguat edhe ju, as që e vëmë në diskutim se duke qenë një marrëveshje kaq e rëndësishme, plus edhe rezultateve që sjell, është edhe në vëmendjen e monitorimit nga institucionet ndërkombëtare.

Pyetja ime ka të bëjë më shumë me zgjerimin e asaj që tha edhe relatori në pyetjen e vet. Kur flasim për plan masash, nuk flasim për çfarë bëjmë ne, sa na monitorojnë dhe si po e zbatojmë. Ne duam të kuptojmë nëse kjo marrëveshje që ne miratojmë sot, ka mundësi të zbatohet direkt apo është e nevojshme të bëhet një akt ligjor, ndryshim në legjislacionin aktual apo akte nënligjore, të cilat përcaktojnë mekanizmat konkrete për atë që është më e rëndësishme, se si bëhet asgjësimi i atyre produkteve që janë në vend, jo ato që na vijnë nga jashtë, sepse, siç e thatë është Drejtoria e Doganave ajo që kujdeset. Çështja ka të bëjë me

faktin: a na duhet ne të shohim me vëmendje nëse kemi apo jo nevojë për ndryshime në legjislacionin vendës, apo duhet të nxjerrim akte të tjera nënligjore, që t'ia arrijmë qëllimit të parashikuar nga ky projektligj, për të cilin jemi sot këtu.

Kjo është ideja jonë për të kuptuar më shumë. Pra, jo thjesht të miratojmë një shtesë në një marrëveshje, e cila mund të ngelet pa zbatim në mungesë të dispozitave ligjore të kuadrit të legjislacionit vendës.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Abeshi.

**Pëllumb Abeshi** – Për momentin, nuk besoj që në aspektin ligjor të ketë nevoja për ndryshime apo amendime, për arsye se ekziston e gjithë baza ligjore. Ky është vetëm një amendim shtesë, i cili kishte për qëllim të përcaktonte një listë të substancave që, tani e mbrapa nuk lejohet të futen në Shqipëri.

Natyrisht, në aspektin organizativ dhe institucional ka nevojë për të forcuar qoftë strukturat që i ka nën varësi Ministria e Mjedisit për të monitoruar, raportuar dhe ndjekur realizimin e kërkesave të këtij të miratuar dhe të këtij amendimi. Natyrisht, më vonë mbase do të duhet edhe rritja e kapaciteteve të institucioneve që merren me asgjësimin e këtyre substancave.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Abeshi!

Po, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit, zoti Abeshi!

Ky është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili ka të bëjë edhe me angazhimet që ne kemi marrë në kuadër të agjendës 2030, sikurse përmendet në relacion.

Relacioni thotë se parashikohen një sërë masash, të cilat ndalojnë importim ose eksportim të disa produkteve, prodhim, mbajtje, riciklim, si dhe përdorim të substancave në fushën e bujqësisë, të riciklimit të gomave e të tjera.

Gjithmonë në kuadër të kontrollit parlamentar, që mund të ushtrojnë komisionet parlamentare, pyetja ime është kjo: a keni ju një kalendar të përgjegjësive, një listë të përgjegjësive të institucioneve që monitorojnë secilin nga këta sektorë? A ka tregues, indikatorë që shërbejnë për të matur punën e çdo inspektoriatit? Pra, jo vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe Ministria e Turizmit.

Pyetja tjetër: a keni ndonjë pritshmëri se kur do të jetë impakti i zbatimit të kësaj marrëveshjeje në kushtet e vendit tonë?

Gjithnjë flas në kuadër të kontrollit parlamentar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Abeshi.

**Pëllumb Abeshi** – Në aspektin e impaktit në vendin tonë, kjo ndikon, sepse tashmë është një listë e substancave që nuk do të lejohen të importohen në Shqipëri. Në bazë të kësaj ne kemi një sistem të ngritur. Në bazë të Protokollit të Montrealit, ministria licencon subjektet, hap një proces, përmes të cilit kompanitë aplikojnë në ministri për të importuar në Shqipëri substancat ozonholluese. Tani do të lejohen vetëm ato që lejohen, dhe ministria e kontrollon këtë proces nëpërmjet lejes që jep. Natyrisht, këtu bashkëpunon me doganën, për të lejuar jo vetëm llojin e substancës, por edhe sasinë e tyre. Sepse kemi detyrime nga protokollit, që të kemi një kuotë të caktuar, të cilën duhet ta respektojmë.

Për sa u takon atyre që janë brenda territorit, që janë nga pajisjet, që mund të jenë nga edhe substancat, hidroflorokarbonet, natyrisht që është detyrim i vendit tonë dhe i strukturave, e kjo është krejtësisht përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit për të ndjekur se si është procesi i eliminimit dhe asgjësimit të tyre.

Subjektet që kryejnë sot këtë proces janë të licencuara, kanë lejen e mjedisit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Njëkohësisht, ato janë subjekt i monitorimit nga Inspektoriat i Mjedisit. Në bazë të këtyre, ata kanë detyrimin të mbajnë regjistrin e substancave që çlirohen ose zëvendësohen gjatë procesit të zëvendësimit të tyre me substancat e lejuara, të ndërrimit të gazit, të themi. Njëkohësisht, kanë detyrimin të paraqesin dokumentacionin: ku e kanë dorëzuar, te cili subjekt i licencuar për asgjësimin e tyre, regjistrin, datën, volumet e të tjera. Më pas bëhet çekimi i subjektit që ka gjeneruar mbetjen dhe subjektit që ka asgjësuar. Është një proces i vazhdueshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Si e masni efektivitetin e kësaj pune, e këtyre inspektimeve?

**Pëllumb Abeshi** – Kjo matet me numrin e inspektimeve, me sasinë e gazit të eliminuar të ndërruar, në raport me atë që është importuar, dhe krahasohet me gjendjen.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Abeshi!

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim, të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet në parim ky projektligj!

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 2.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Edhe ky projektligj, së bashku me relacionin përkatës, i përcillet komisionit përgjegjës, e më pas seancës plenare për votim.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017". (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Silva Caka, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani - Drejtore në Drejtorinë e Fondeve të BE-së në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës, dhe të fundit për sot, që është shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë kolegu Spartak Braho. Nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Gazmend Barbullushi, Sekretar i Përgjithshëm dhe zonja Daniela Cekani, drejtore në Drejtorinë e Fondeve në BE.

Zoti Barbullushi, mirë se keni ardhur në komision!

Edhe për ministrinë tuaj vlen e njëjta vërejtje, të cilën duhet t'ia përcillni ministrit: niveli i përfaqësimit në komision. Tashmë është çështje e ezauruar kjo ndërmjet Kuvendit dhe qeverisë, kështu që shqetësimi do të duhet t'i përcillet.

Po jua kaloj fjalën, që të bëni shkurtimisht një prezantim të këtij projektligji. Më pas do t'ia kaloj fjalën kolegut Braho.

Fjala është për ju.

**Gazmend Barbullushi** – I nderuari zoti Manja!

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë!

Shkurtimisht, do t'ju prezantojmë sot ligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Qëllimi i këtij projektligji është propozimi për ratifikimin e marrëveshjes së sipërcituar. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Komisioni Evropian në janar të këtij viti, nga Maqedonia në mars të këtij viti, nga Shqipëria në gusht të po këtij viti. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri 2014 - 2020 u miratua nga komisioni me vendimin e tij zbatues 9674, në dhjetorin e vitit 2014.

Konkretisht, alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit Evropian, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 milion e 190 mijë euro, për të dyja vendet. Duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të të dy shteteve, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2017 arrin në vlerën 1 milion e 400 mijë euro. Domethënë vlera e bashkëfinancimit është 210 mijë euro.

Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë Bashkimi European për zbatimin e përbashkët të të gjithë programit Maqedoni-Shqipëri për periudhën 2014 – 2020, arrin në vlerën 11 milionë e 900 mijë euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë patjetër subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare mes vendit tonë, Maqedonisë dhe Komisionit European.

Përfitues të programit janë zonat për shtetin maqedonas, rajonet Pelagonia, Pollogu dhe rajoni jugperëndimor. Për Shqipërinë janë qarqet Dibër, Elbasan e Korçë.

Programi në fjalë synon të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare, të forcojë bashkëpunimin mes dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Programi mbështet shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis subjekteve përfituese, si dhe ndikon në përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare rajonale e lokale, në hapësirën ku do të zbatohet.

Duke marrë parasysh aspektet apo më mirë problematikat që ndikojnë në ekonominë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, programi fokusohet në tre prioritet kryesore:

- nxitjen e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore,
- rritjen e konkurrencës, biznesit, tregtisë, investimeve,
- mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe lehtësimin ndaj ndryshimeve klimaterike, ku kemi parasysh edhe parandalimin e menaxhimin e risqeve të mundshme.

Është bërë një thirrje, thirrja e parë, në shtator të vitit 2016. Kjo thirrje ka pasur si buxhet total rreth 2 milionë e 900 mijë euro për alokimet e viteve 2014-2015. Kontrata e financimit ka përfunduar me mbishkrimin për periudhën tetor 2017 – janar 2018 dhe tashmë ka nisur implementimin e tyre. Gjithsej janë 8 projekte fituese.

Thirrja e dytë do të lanohet së shpejti brenda këtij viti dhe prioritetet e thirrjes do të jenë: turizmi, trashëgimia kulturore, natyrore, mjedisi, parandalimi dhe menaxhimi i risqeve.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky është një informacion i shkurtër lidhur me parametrat e programit. Për detaje dhe informacione të tjera jemi në dispozicionin tuaj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Pa u zgjatur, zoti kryetar, të nderuar kolegë, unë konfirmoj plotësisht paraqitjen që bëri sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, me përjashtim të një vërejtjeje që kam, që kjo marrëveshje është nënshkruar me vonesë nga ana e Shqipërisë. Fushat e përdorimit janë ato që përsëriti dhe evidentoi zoti Barbullushi. Me interes është veçanërisht rrethet që do të përfitojnë nga ky projekt, siç janë: Dibra, Elbasani dhe Korça.



Në aspektin ligjor dhe procedural marrëveshja është konform Kushtetutës. Kam një pyetje, të cilën edhe ju e përmendët: a do të vazhdojmë ne ta quajmë Republika Popullore Socialiste e Maqedonisë?

**Gazmend Barbullushi** – Marrëveshja është e BE-së.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braho!

Duke qenë se kjo është një marrëveshje në kuadrin e BE-së, nuk besoj se ka ndonjë gjë të paqartë, siç e shpjegoi dhe kolegu Çuçi.

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkuftar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Ky projektligj do t’i dërgohet seancës plenare të radhës për votim.

Falënderoj zotin Barbullushi dhe zonjën Çekani!

Me miratimin e këtij projektligji e mbyllim mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t’u njoftohet kolegëve nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**

